



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 4500/9 Prot.

Pogradec, më 23. 12. 2025

VENDIM

NR. 125, DATË 22. 12. 2025

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25.11.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 25.11.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 25.11.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI

1.Miratuar me 23 vota

2.Vota Pro 23

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 23.12.2025



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

ORA : 12:00

PREZENT: 22 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 10.11.2025 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 10.11.2025.
4. **Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Tetor 2025
5. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Bujar Elezi në Bashkinë Pogradec.
6. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Edmond Alla në Bashkinë Pogradec.
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Fatmir Muca në Bashkinë Pogradec
8. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e Planit të Aktiviteteve dhe Planit të Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec per vitin 2026.
9. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e shpenzimeve nga buxheti I Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, për qëllime ndërtimin e parkut eloik në Bashkinë e Pogradecit subjektit “RENX ALBANIA” shpk.
11. **Drejtoria e Taksave, Analiza 10 mujore për vitin 2025 për mbledhjen e të ardhurave.**

12. Informacion, Raporti I Performancës I Bashkisë Pogradec për vitin 2024.

13. Të tjera.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

- Miratimi i Rendit të ditës.

Znj.Kamolli: Përshëndetje të gjithëve! Jemi mbledhur sot në takimin e radhës të Këshillit Bashkiak. Sipas ligjit 139/2015 të nenit 53 pika 4. Materialet ju janë dërguar si në formë fizike ashtu edhe në formë elektronike.

Mbledhja deklarohet e hapur.

Znj.Bojko: Prezent janë 21 Këshilltarë, mbledhja deklarohet e hapur.

Znj.Kamolli: Vazhdojmë me axhendën e ditës, dëshiroj të them që salla sot është e dekoruar për arsye që sot u cel fushata 16 Ditë Aktivizëm në ditën Ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Motoja e kësaj Fushate është për ti dhënë fund dhunës dixhitale ndaj grave edhe vajzave. Ky Aktivitet u organizua nga Bashkia Pogradec , Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shoqata UNË Gruaja . Ne si Këshill dhe si aleancë e grave Këshilltare ju bashkuam kësaj nisme, ishte shumë bukur, simboli I këpucëve të kuqe ku të gjithë dëshironin të tregonin që dhe gratë edhe vajzat janë të lira, të forta, të sigurt ku shprehëm angazhimin e përbashkët në mbrojtjen e viktimave të dhunës, sidomos atyre të dhunës dixhitale. Kësaj nisme ju bashkuan edhe nxënësit e shkollës “Gjergj Pekmezi” . Së bashku duhet të vazhdojmë të bëjmë më të mirën, të zbatojmë politika sa më të drejta për të qënë në mbështetje të grave dhe vajzave, Ju faleminderit! Vazhdojmë me rendin e ditës, lexojmë rendin e ditës. Kemi një projekt-vendim shtesë . Është për familjet që patën dëme nga përmytja, për situatën emergjente që u krijua për 6 familje ku banesat e tyre janë të pabanueshme. E hedhim në votim për tu futur te rendi I ditës.

Miratohet me 21 vota Pro

E hedhim në votim rendit e ditës, kush është dakort ju lutem!

U votua

Kundër 0,

Miratohet PO JO

Pro 21

Abstenim 0



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen

lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Nëse dikush ka ndonjë konflikt interesi lidhur me çështjet e ditës, ju lutem mund ta deklarojë.

Faleminderit vazhdojme.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'J. B.', located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 10.11.2025.

Jeni dakort! E hedhim në votim!

Ju faleminderit!

U votua

Pro 21

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'J. B.', is located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

Projekt – Vendim : Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Tetor 2025.

Për muajin Tetor 2025 janë rekomanduar të trajtohen me ndihmë ekonomike 175 familje me një fond prej 734837 lek.

Znj.Kamolli: Kemi dëkka për të pyetur, e hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Projekt – Vendim: Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Bujar Elezi në Bashkinë Pogradec.

Znj.Kamolli: Kemi dicka për të thënë, e hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Projekt – Vendim: Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Edmond

Alla në Bashkinë Pogradec.

Znj.Kamolli: Kush është dakort,kundër,abstenim.Faleminderit!

U votua

Pro 21

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo



-Projekt – Vendim: Për miratimin e bonusit të qerasë për z.Fatmir Muca në Bashkinë Pogradec.

E hedhim në votim, Faleminderit!

U votua

Pro 21

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo



Mbledhja e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Projekt – Vendimi: Për miratimin e Planit të Aktiviteteve dhe Planit të Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026

Z.Kryetare: Projekt-Vendimi u diskutua në Komision, nëse dikush nga ne ka dicka është i lutur të flasë. Ju lutem ngrini dorën të merni fjalën.

Znj.Topa: Përshëndetje! Para Mbledhjes së Këshillit u mbledhën Komisionet , u diskutua edhe për planin theksoj këtu që pjesëmarja e Komisioneve nuk ishte e plotë, prandaj nqs ka dëshirë që dikush të flasi dhe të japi ndonjë sugjerim. Shumicën e planifikimeve ne e bëjmë cdo vit , gjatë Komisioneve nuk patëm propozime nqs këtu ka ndonjë propozim nga këshilltarët që nuk ishin prezent.

Znj. Kryetare: Atëherë e hedhim në votim, por ky është një plan që mund të pasqyrohet herë pas here në Aktivitet në varësi të asaj që do na dali.

Hidhet në votim pika 8 e Rendit të Ditës.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

-Projekt –Vendimi: Për miratimin e shpenzimeve nga buxheti I Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026

Znj. Kryetare : Mund të na jepni nga Financa një sqarim ju lutem.

Z.Haxhillari: E vecanta e këtij Projekt-Vendimi është vetëm ajo e sistemit të ngrohjes, shpresoj që të realizohet.

Znj.Marjeta: Është shtuar tek Këshilli?

Znj.Kryetare: Është shtuar tek buxheti jonë I Këshillit për kondicioner që nuk mundëm ta realizojmë këtë vit edhe për një sistem elektronik të votave.

Znj.Pllaha: Më e rëndësishme është sistemi I ngrohjes.

Znj.Kryetare: Në fakt Shefja e financave nuk është edhe në pamundësi të merja pjesë në Komisione, por një propozim që do kisha dashur të përcaktohet një sasi naftë për Këshillin për të patur më të lehtë lëvizjen e transportit për Konsultimet Publike. Mund të caktohet një mjet nga Bashkia ,për të mos blerë një mjet vetëm për ne.

Z.Shyti: Gjithmonë që na është dashur automjetet e Bashkisë kanë qënë në dispozicionin e Këshillit.

Znj.Kryetare: Problemi është kur automjetet e Bashkisë janë të zëna ose të prishura, problem është gjithashtu kur kemi aktiviteta dhe ne na duhet të shkojmë dhe kuptohet për ato që ndodhen larg se për ato që janë afër I kemi përballuar vetë.

Z.Gjona: Pyetja ime ishte se kur do bëhet pagesa e Këshilltarëve edhe Kryetarve të Fshatrave që nuk është realizuar akoma, kanë 4 muaj që presin pagesën. Do ishte mirë të na thonë kur do paguhen.


Znj.Marjeta: Tju bëj edhe unë një pyetje. Administrata I ka marrë rrogat? Kryepleqtë sjanë paguar akoma.

Z.Gjona: Pyetja ishte kur do I marrim?

Znj.Kanina: Besoj nga java e parë e Dhjetorit por jo e plotë kamë përshtypjen.

Znj.Marjeta: Arsyeja?

Znj.Kanina: Arsyeja është që llogaria e juaj është e ndryshme nga llogaria e pagave. Aktualisht jemi përsëri të bllokuar nga disa Përmbarues për detyrimet e prapambetura të Bashkive të kaluara.

Znj.Marjeta: Faji nuk është I joni.

Znj.Kanina: Absolutisht as I joni jo.

Znj.Marjeta: Tju them dicka. Vetëm në Bashkinë tonë ndodh kjo gjë apo edhe në Bashkitë e tjera.

Znj.Kanina: Kam përshtypjen dhe një informacion që nuk I kalojnë cdo muaj Këshillit Bashkiak.

Znj.Topa: Mund të them dicka ju lutem se kjo temë është bërë një diskutim I gjërë. Mendoj që ne të paktën këtu nuk duhet të shprehemi kursesi a I ka marë Bashkia rrogat. Punonjësit e Bashkisë punojnë me orar të plotë. Edhe ne duhet ti marrim edhe kjo është normale, por nuk mund të jemi ne prioritet para punonjsve të Bashkisë patjetër që edhe ne na takojnë absolutisht. Funkzioni jonë është më shumë se kaq, është Mision nuk është funksion ne e kemi pak më të gjërë se kaq dhe jo për të bërë paralelizma, ky është mendimi im.

Znj.Kryetare: Po ju faleminderit, vazhdojmë e hedhim në votim nqs nuk kemi dicka për të shtuar. Po Z.Male , në lidhje me temën ju lutem.

Z.Malaj: Përderisa këtë fond e keni të parashikuar në buxhet pse duhet të kërkojmë naftën është e kuptueshme në momentin që Bashkia nuk ka makinë në dizpozicin . Jo të gjithë mund ta kenë mundësinë të paguajnë karburantet që në



zonën e Mokrës shkon të paktën 30-40 mijë lekë dhe për derisa kemi fondin nuk ka arsye pse mos përfitojme.

Znj.Kryetare: Në fakt për këtë e kasha fjalën edhe unë kur fola për naftë,por ka Këshilla Bashkiak të cilat e kanë bërë praktik këtë gjë se duhet në funksion të Këshillit. E hedhim në votim ju lutem.

U votua

Pro 22

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo



- Projekt – Vendimi: Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullësor, për qëllime ndërtimin e parkut eolik në Bashkinë e Pogradecit subjektit “RENX ALBANIA” shpk.

Vazhdojmë me Projektin e rradhës, ju lutem tek pjesa që është eolik duhet eolik. Ndryshoheni ju lutem e thamë që herën e kaluar. Ja japim fjalën Z.Torra.

Z.Torra: Eolikë e kemi shkruar ne por e gjejmë dhe bëjmë ndryshimin e duhur. Atëhere subjekti “RENEX ALBANIA” në vitin 2023 ka marrë miratimin nga ana e Bashkisë për miratimin në parim të vënies në përdorim të qëllimit të studimit të tipit të parqeve eolikë. Që nga ajo ditë edhe deri më sot kompania ka studiuar pozicionin e erërave dhe ka dalë në konkluzionin që në Bashkinë e Pogradecit në vendimin që ne kemi marrë dhe në kontratën e lidhur me subjektin në atë kohë ka qënë , që ai duhet të pajiset me autorizim edhe leja përkatëse nga Ministria. Kompania është pajisur me vendimin përkatës për ndërtimin e një Parku Eolik me kapacitetin 120 mega vat, i cili do ndërtohet në zonën e Cervenakës dhe deri në pjesën e rrugës që lidh Cervenakën me Homcanin. Në pjesën tonë do të ndërtohen 8 turbina dhe pjesa tjetër prej 15 turbinash janë në zonën e mbrojtur që nuk është pjesë e këtij projekt- vendimi. Sipërfaqia që secila turbinë ze është 4500 metra por në momentin e parë ne kemi llogaritur 7500. Vetë kompania ka bërë një Konsultim Publik para një viti ne jua kemi paraqitur në mbledhjen e parë. Në dt 10 u organizua një konsultim tjetër public nga Këshilli i Bashkisë pranë Njesisë Udënisht. Kanë qënë pjesmarës Këshilltarët që mund të flasin vetë. Ne mendojmë që është investim i mirëpritur që duhet miratuar për të vazhduar. Ka marrë paraprakisht të gjitha lejat e nevojshme nga Ministria dhe mbas miratimit që ju besoj do bëni në këtë Këshill. Sektori Pyjor do bëj raportin teknik përpara lidhjes së kontratës ku do përcaktohen detyrimet që objekti do paguajë pranë Bashkisë, duke përcaktuar edhe rrugët e aksesit vendosjen e centralit dhe linjat elektrike. Në total ne kemi kërkuar 4.5 ha po pa llogaritur linjat, ngaqë linjat





Ilogariten në km. Ne nuk mund të themi që është fiks prandaj edhe në titull e kemi hequr sipërfaqen.

Znj.Kryetare: Ka pyetje kush e do fjalën.

Z.Male: Meqënëse u tha 4.5 hektarë sa mund të shkojë?

Z.Torra: Unë thashë 4500 metra do përdoret turbine gjatë ndërtimit dhe funksionimit, ndërsa 7500 metra, pjesa e rrugëve edhe aksesit te linja nuk janë llogaritur sepse llogaritet me km. Ne kemi llogaritur që të gjitha këto linja kalojnë në pronën e Bashkisë.

Z.Male : Përderisa në Konsultimin Publik nuk ka pasur kundërshtime nga banorët edhe ne si Kryetarë të Këshillit jemi pro për zhvillim kur edhe banorët nuk preken nga Projekti. Prandaj dua të saktësoj edhe dikë që ne nuk jemi kundër sepse është krijuar ajo ideja që kundërshtojmë cdo Projekt, por ne nuk jemi kundër në momentin që është pronë e Bashkisë dhe aty nuk preken banorët është bërë konsultimi edhe të gjithë janë dakort. Unë personalisht kam folur me Kryeplakun e Udënishtit edhe me disa banorë edhe as një nuk u shpreh kundër aq më tepër që nuk parqë voltaikë që e izolojnë.

Znj.Kryetare: Shumë mirë faleminderit po z.Gjona.

Z.Gjona: Unë isha pjesë e Konsultimit Publik në fakt kishte një kërkesë nga banorët e fshatit që është pjesë e zonës së Mokrës për hapjen e një transeje rruge rreth 2 km nuk e di nëse do bëhet. Mund ta vendosim si kusht firmës për ta hapur atë rrugë që l'hyn në punë shumë komunitetit për arsyen se shkurton goxha rrugë.

Z.Torra: Në konsultimin Publik janë shprehur jo një por dy kërkesa, një nga fshati Udënisht dhe një nga fshati Homezh për rrugë.. Me mbarimin e konsultimit public unë direkt kam kontaktuar me firmën edhe Kryetari e dinte si problem por kemi të bëjmë me një territor shumë të vështirë. Do shohim mundësinë se si mund të aksesohet, në momentin që firma do lidhë kontratën besoj që do ti kërkohej që cdo gjë që mund të aksesojnë të bëhet për të mirën e komunitetit.




Z. Haxhillari: Ne diskutuam edhe në komisione dhe po flasim për një projekt se duke pasur parasysh që Fjerza është 500 mega vat dhe duke marrë parasysh me këto parametra I bie të jetë shumë I fuqishëm. Pra në këtë aspekt nuk mendoj se duhet të kemi ndonjë supozim tjetër përvec një votim të hapur.

Znj: Kryetare : Në rregull atëhere e hedhim në votim.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 3 (Marjeta Biba , Klajdi Gjona, Frederik Pikuli)

Miratohet **Po** **Jo**





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.11.2025

Për miratimin e bonus qerrasë për Z. Iljaz Braci, Z. Pëllumb Kuqo, Z. Muhamer Mahmutllari, Z.Nestan Mahmutllari, Z.Luan Bezatlliu dhe Z. Riza Kopaci në Bashkinë Pogradec janë familjet që pësuan dëmtimet të mëdha nga përmbytja.

Z.Dulellari: Para se të diskutohet mund të bëj një sqarrim ju lutem.

Znj.Kryetare: Po

Z.Dulellari: Faleminderit të gjithëve për rastet emergjente në fjalë që kanë ndodhur në dt 21.11.2025 dhe një këshillë nga ana ime ku duhet të ishin disa Këshilltarë në teren qoftë nga ju apo edhe nga Bashkia sepse do ishte një mesazh i mirë për këtë situatë faleminderit.

Për rastin në fjalë nga përmbytjet që ndodhen ka qënë prezent edhe Kryetari i Bashkisë Pogradec, Këshilltar i këshillit Arbër Male ku gjej rastin edhe ta përshëndes. Grupi i punës në teren janë evidentuar sipas grupit të shtabit që është në teren, për të gjitha familjet e dëmtuara nëpër fshatra edhe në qytet janë konfirmuar nga Administratorët dhe Drejtoritë përkatëse. Janë evidentuar të gjitha tokat edhe parcelat buqësore, stallat, bizneset, shkarjen e dherave , dëmtime urrash etj janë evidentuar nga grupet e punës përkatëse. Janë rreth 61 familje që janë dëmtuar në orendi, banesa, blektori totale ose të pjesshme catitë etj. Po shënohen aktualisht nga grupet e punës që janë ngritur nga dy persona për cdo dëm që ka ndodhur në dërshtëpërlim. Ju është dërguar shkresë përkatëse në Qarkun e Korcës edhe të Tiranës. Paketë ndihmash urgjente ku po shpërndahen nga Grupet e punës aktualisht sikurse e keni parë edhe në hyrje të Bashkisë. I kërkojmë Këshillit Bashkiak në një situatë të jashtëzakonshme të miratojë në parim për bonus qeraje sipas listës që kemi sjellë, sepse këto familje janë në kushte ku janë rrënuar totalisht shtëpitë.



I kërkojmë Këshillit që të planifikojë një mbledhje të jashtëzakonshme jashtë rradhe më pak se 10 ditëshin e parë të Dhjetorit për kompesimin dhe dëmshpërblimin për dëmet që janë bërë në cdo familje, sipas ligjit. I gjithë dokumentacioni tekniko ligjor do përgatitet nga zyra jone. Ju faleminderit

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



11. Drejtoria e Taksave, Analiza 10 mujore për vitin 2025 për mbledhjen e të ardhurave.

Znj.Enjela: Doju tju thoja dicka në analizën që ju është shpërndarë, përfituesit e familjeve janë ashtu sic ne I kemi marë në fund të viti. Nuk kamë bërë një listë të re pasi më janë dërguar shumë vonë nga Ujësjiellësi. Do jua sjellim të detajuara në listat që do bëjmë në Janar.

Znj.Kamolli: Ju lutem dëgjojmë.

Znj.Enjela: Desha të theksoja pak tek familjet, të dhënat që janë marë për planin 2025 ju përkojnë Djektorit të vitit të kaluar 39 mijë e 24 familje, por duke marrë informacionin nga të gjitha Njësitë Administrative jemi bazuar tek 24 mijë 120. Doja të theksoja që janë rreth 5827 familje, pensionistë dhe me ndihmë ekonomike që përfitojnë lehtësimin prej 30% ulje të tarifave edhe heqjen e taksës së pasurisë. Kemi edhe 649 familjare femra ose pesnionist që jetojnë vetëm që nuk paguajnë tarifa. Në total planifikimi I plotë është për 17 mijë e 645 familje. Tek bizneset në fund të vitit të kaluar kemi patur 1953 biznese në të gjithë Bashkinë, të cilat janë të ndara edhe 23 institucione të cilat paguajnë të gjitha tarifatat. Unë do doja të cilësoja që ne kemi realizuar 77% të planit, vazhdoj të theksoj për këtë situatë jemi më mirë se vitin e kaluar kun ë këtë perudhë kemi qënë në 69% është taksa e ndikimit në ifrastrukturë që përsëri ndikon.

Si drejtori ne jemi 83% të realizimit dhe nga këto në vlerë leku kemi mbledhur vetëm Drejtoria e Taksave ka mbledhu r279 milion 143 mijë e 786 leke ku nga këto 9.6 milion janë mbledhur nga debitorët, nga bllokimet bankare kemi bllokuar automjetet dhe më pas do kalojmë në pasuritë e paluajtshme.

Mund tju them ku kemi cuar në process gjyqësor një subjekt ku ka një vlerë të konsiderueshme për të parë se si procedohet. Ligji nuk na lejon të mbyllim aktivitetin, por kemi marë masa të bllokimeve bankare të automjeteve dhe të pasurive të paluajtshme të këtij aktiviteti nuk kemi patur rezultat edhe e kemi cuar në Prokurori ka mbaruar gjykimi I parë ku ne kemi fituar çështjen , por presim pjesën e ankimimit ku e gjithë vlera do kalojë dhe shpresojmë që do kemi një rezultat. Pasi përfundoi kjo procedurë ne ju kemi dërguar edhe dy subjekteve të tjera. Subjekti tjetër është Eurokorca me të dy pronarët sepse gjatë gjithë periudhës ka patur dy pronarë të ndryshëm. Do aplikojmë në këtë mënyrë për subjektet që



kanë vlera të konsiderueshme nuk mund të cojmë në Gjykatë vlera të vogla. Tek materiali që ju keni në dorë ju kam vendosur edhe shkresat që ne kemi dërguar në këto subjekte . Dua të ndaloj pak në krahasimin e dy artave në vlerë ku ne dallojmë që ato shkojnë me ritje, mund të themi që kemi një punë më të mirë të Drejtorisë së Taksave e kemi realizuar plotësisht objektivin tonë. Jam përpjekur që drejtoria të ketë një performancë të mirë, por varet nga të gjithë , ndërgjegjësimi i qytetarëve. Mendoj që jemi përpjekur të jemi pranë qytetarëve në të gjitha kërkesat që ata kanë. Po ashtu edhe bizneset i kemi ndihmuar, jemi aty për çdo nevojë që ata kanë.

Nëse keni ndonjë pyetje ju lutem!

Znj.Shuli: Faleminderit Enjela!

Znj.Enjela: Përpara se ju do vazhdoni pyetjen doja të thoja edhe dicka.. Kemi konstatuar edhe vetëm qyteti ka rreth 95 subjekte që janë pa lejë. Të them të vërtetën shumica janë tek pjesa e Gabit ku kam patur një përballje shumë të madhe dhe kam ndjekur rrugën ku ju kam dërguar shkresat përkatëse, për herë të parë kam marrë një përgjigje positive për të erdhur inspektorët për bashkëpunim , ku më kanë kërkuar konstatimet edhe fotot. Kam bërë gati gjithë dokumentacionin përkatës për tju dërguar. Shpresoj shumë shpejt të kemi bashkëpunimin.

Z.Shyti: Vetëm pjesën e Liqenit duhet të kemi pak merak.

Znj.Enjela: Zona e Liqenit është e gjitha e rregullt. Kemi problem me Njësitë Administrative. ku ne jemi mjaftuar vetëm me konstatimin .Në takim nuk kemi dërguar këtë pjesë. Thjesht kemi ndjekur këtë parime.

Znj.Shuli: Faleminderit për prezantimin, duke parë një punë mjaft të mirë nga ana e juaj ku e tregojnë edhe arritjet ne % për dhjetë mujorin e fundit. Në fakt shqetësim ngelen bizneset e pa licencuara, ju thoni që keni rekorduar në takime edhe shkresa, duhet që këto shkresa të shkojnë pranë Hetimit tatimor në Tiranë. Hetimi tatimor ka të drejtë të mbyllë biznesin, sepse nje biznes nuk mund të vazhdojë pa u lincensuar, të punojë edhe të jetë me gjoba, të ketë disa detyrime marramëndëse edhe janë biznese të mëdha. Ju sapo thatë pak më përpara që ka disa biznese të mëdha që nuk shlyejnë detyrimet, unë nuk dua të përmend emrin e bizneseve që kanë disa vite që nuk shlyejnë detyrimet.Bashkia ka gjithë të drejtën e mundshme me bashkëpunim me hetimin tatimor të mbyllë një biznes.Ka dy arsye





përvec se Bashkia nuk arrin të marrë taksat rrëndon edhe në bizneset e tjera. Është një detyrë shumë e rëndësishme mbledhja e taksave, nuk është e drejtë një pjesë të punojnë të licensuar edhe një pjesë jo. Faleminderit!

Znj. Enjela: Ne kemi shkuar deri në Prokurori, nuk është e drejtë sepse ligjërisht bëhen bllokimi i automjeteve, pasurive të paluajtshme, por me vendimin që ka marrë Prokuroria do e cojë në Permbarim edhe ajo vlerë do meret. Problematika është tek bizneset e vogla ku ndodh një konkurrencë e pa ndershme. Problematika qëndron tek pagimi i sigurimeve, kemi hasur shumë vështirësi. Jam shumë dakort kemi ngritur një taks forcë tani brenda muajit Dhjetor, ku do të vendosen edhe shiritat. Vendosja e shiritit bëhet vetëm tek ata që nuk janë të regjistruar jo tek ata që janë debitorë. Nuk na lejon ligji sepse mendohet të punojnë edhe të shlyhen detyrimet. Jemi qytet i vogël dhe kuptohet që ka dhe raste që duhet të tolerohen, problem është tek pjesa e tregut, por kur shikon një pjesë që me ato jetojnë, kuptohet duhet të kemi një konkurrencë të rregullt.

Znj. Shuli: Nuk mund të merremi me një që shet fruta-perime ku mban familjen, të merremi me bizneset e mëdha, problemi është tek bizneset që janë ngritur nëpër lagje dhe shesin kafe janë locale të pa licensuara. Kjo është pa barazi në biznes.

Z. Male: Unë jam dakort që ta nisim pikë së pari nga ato që ka evidentuar edhe shteti, atje ne shohim që jo vetëm biznese të vogla por edhe biznese të mëdha kanë detyrime në Bashkinë e Pogradecit, nuk besoj që këto vuajnë nga financat. Sikurse edhe shumë subjekte të tjera që ju i keni evidentuar edhe vetë.

Nisur nga karburantet edhe nga ato biznese që ne kemi folur disa herë, nga një eksperiencë e afërt e një mikut tim ku Bashkia e Tiranës i bllokoi llogarinë bankare për një shumë 360 milionë të vjetra.

Znj. Enjela: Llogaritë bankare janë bllokuar tek të gjithë.

Z. Male: Ju e kuptoni çdo të thotë ti bllokosh një biznesi llogarinë Bankare.

Znj. Enjela: Llogaritë Bankare, Automjetet, posuritë e paluajtshme janë bllokuar për të gjithë debitorët pa përjashtim.

Z. Male: Bizneseve të mëdha pse nuk merren masa? Ju kuptoj që influenca e tyre është shumë e madhe, ju shqetësojnë edhe nëpër telefona edhe këtë gjë e kuptoj.



Bashkia e Pogradecit është në një situatë që nuk mund të bëjë tolerime të paktën tek biznesi I madh.

Znj.Enjela: Ju referohemi të paktën 2 viteve të fundit që nuk kemi rritje në taksa, janë dy subjekte .

Z.Male: Jo janë më shumë.

Znj.Enjela: Autorizimet janë të gjitha të paguara, po të dëshironi e lexojmë bashkë, janë vetëm dy subjekte që faktikisht I kanë marrë disa të tjerë me qera. Atyre ju ka mbaruar leja, tani kanë filluar edhe ne ja kemi cuar gjithë shkresat përkatëse. Besoj brenda këtij viti të gjithë do jenë në rregull. Përsa I përket pjesës tek Minierat është një problem.

Z.Male: Here pas here janë sjellë ,duhet ti gjeni zgjidhjen këtij problem.

Znj.Enjela: Unë thjesht kam këmbëgullur sepse ato janë biznese që dëmtojnë zonën, por kam hasur vështirësi sepse hidrocentralet janë të gjitha me kontrata. Dëmin më të madh ata e bëjnë.

Z.Male: Bashkia nuk ka mekanizma, nuk duhet të përgjigjet dikush për këtë pjesë, përse këto subjekte nuk paguajnë rreth 170 mijë euro në Vit.

Znj.Enjela: Pyjorja është më e saktë për të të dhënë një përgjigje përfundimtare. Po flas për ato që janë me lejë Minerale.

Z.Genci: Po për këto aktivitete që zenë nga 3 – 4 parkime si funksionon jam I sigurtë që nuk paguajnë.

Znj.Enjela: Kemi tre Vjet ku drejtoria jonë nuk meret më me parkimet.

Znj.Kryetare: Ju lutem mos devijojmë nga tema. Dakort nqs doni mund të thërrasim personin përgjegjes dhe mund ta diskutojmë. Kemi pyetje tjetër për Drejtoreshën.

Z.Gjona: Kur shohim tabelën e të dhënave shikojmë një realizim relativisht të ulët, kjo vjen si shkak të të dhënave të sakta për banorët që jetojnë atje apo formës së organizimit.



Znj.Enjela: Ne kemi publikuar nga Administratorët edhe jam shumë e kënaqur nga Proptishti edhe Velcani. Kur punonjësit dalin në terren kuptohet kemi edhe një përfundim pozitiv. Kurse për Trebinjën kemi rezervat tona.

Z.Gjona: Edhe banorët e asaj zone kishin rezervat e tyre për Bashkinë.

Znj.Enjela: Doja tju sqaroja ku plani këtë vit do ketë ulje edhe sipas rekomandimit që vjen nga KLSH. Prandaj edhe ne jemi akoma duke diskutuar por di të them që do vijë një plan sa më i detajuar dhe sa më lart. Deri tani plani ka qënë reala ka qënë mbi bazën e taksueshme, por mbledhja nuk ka qënë 100%.

Znj.Kryetare: Shumë faleminderit ju edhe grupit tuaj të punës, shpresojmë sa më shumë punë edhe të ardhura. Kalojmë kë pika e radhës ju lutem.



Informacion, Raporti I Performancës I Bashkisë Pogradec për

vitin 2024

Znj.Alla: Përshëndetje do tju prezantojmë Raportin e Performancës 2024.

Raporti i Performancës 2024 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar. Ky raport është përgatitur nga Bashkia Pogradec, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2024). Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë Bashkia Pogradec e pozicionuar në juglindje të vendit përbëhet nga 7 Njësi Administrative: Bucimas, Cërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Udënisht dhe Velcan me sipërfaqe prej 549 km². Popullsia e bashkisë numëron rreth 46 mijë banorë sipas censusit 2023 dhe rreth 91 mijë banorë sipas të dhënave të Regjistrat Civil. Janë tabelat përkatëse për cdo pikë më vetë.

Arsimi Parauniversitar

Menaxhimi I mbetjeve

Mbrojtja nga zjarri

Menaxhimi I Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit

Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave

Mbrojtja Sociale

Burimet Njerëzore

Transparenca

Barazia Gjinore

Integrimi Në BE

Menaxhimi Financiar

Ju faleminderit!



Znj.Topa: Mjë sugjerim kisha për Institucionin e Bashkisë., duhet të vendosni më shumë materiale edhe kur shikojmë disa objektiva të pa arricme nuk ka përse të jenë të tilla, ky është një sygjerim realisht vendosni objektiva që mund të realizohen,, sepse disa pika në plan nuk është se nuk realizohen. Janë përkeqësuar nuk e di se për cfar arsye.Nuk e kam personalisht me ju, po flas për Bashkinë. Ju po drejtoni planin dhe për këtë arsye ju drejtova. Ju faleminderit!

Znj.Kryetare: Sygjerimi im është që këto raporte të vijnë më herët.Ju faleminderit!

Vazhdojmë me Projekt –Vendimin e rradhës që është shtesa që ne sapo folëm.

Znj.Kryetare: Lexojmë edhe kërkesat që kanë ardhur ju lutem.

Kemi dicka tjetër ju lutem.

Znj.Topa: Në adresën time si Kryetare Komisioni të mandateve ka ardhur një kërkesë lidhur me pajtueshmërinë ligjore të anëtarëve të Kwshillit Bashkiak. Ka edhe një afat njoftimi ne duhet ti përmbahemi dua të them që në mbledhjen e rradhës do trajtohet kërkesa nëse do të jemi gjithmonë përpara kushteve të papajtueshmërisë ligjore. Kërkuesi është Armand Braho ja ka deleguar Prefekturës, Prefektura ma ka deleguar mua. Unë do zbatoj rregulloren e brendshme.Faleminderit!

Znj.Kamolli Faleminderit e deklaroj mbledhjen e mbyllur.

